



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	23.05.2024 <u>01-463102-7986</u>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër kadastral P-70705029-00468 - 23, Z.K Gjakovë - Qytet

Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe dispozitat e Statutit të Komunës së Gjakovës, me datë 23.05.2024 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër kadastral P-70705029-00468 - 23, Z.K Gjakovë - Qytet, e evidentuar në emër të Komunës së Gjakovës, sipas marrëveshjes së negocimit mes të Komunës së Gjakovës dhe “Jeton Bakalli”, me numër 01-463/01-7892, të datës 22.05.2024.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është afatgjatë, përkatësisht 99 vite.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është interesi publik, përfitimi ekonomik i Komunës nga prona komunale si dhe funksionalizimi i pronës komunale në bazë të Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës.

4. Mënyra, kushtet dhe kompensimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës, do të përcaktohen në kontratë sipas marrëveshjes së negocimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe “Jeton Bakalli” me numër 01-463/01-7892, të datës 22.05.2024.
5. Pjesë përbërëse e propozim vendimit janë: Kërkesat e palës, Marrëveshja e negocimit mes Komunës së Gjakovës dhe “Jeton Bakalli”, Projekti i paraqitur nga investitori dhe plani dinamik i realizimit të investimit, paramasa dhe parallogaria, Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit, Certifikata e regjistrimit të biznesit, Vërtetimi që nuk ka obligime tatimore, si dhe qarkullimi bankar për vitin paraprak i biznesit “Jeton Bakalli” B.I.

Me respekt!